215	Ded	Lulash	Lamthi	2827	81/7	3250	154	233	35882							35882	konfirmuar
216	Gezim	Preke	Demaj	2827	81/6	3000	174	233	40542							40542	konfirmuar
217	Arben	Gjergj	Uldedaj	2827	81/4	6250	510	233	118830							118830	konfirmuar
218	Arben	Gjergj	Uldedaj	2827	81/3	2500	279	233	65007							65007	konfirmuar
219	Arben	Gjergj	Uldedaj	2827	81/2	2590	283	233	65939							65939	konfirmuar
220	Zorka	Daniel	Ceklaj	2827	81/1	2500	286	233	66638							66638	konfirmuar
221	Gjoke	Martin	Lepeja	2827	6	2000	327	233	76191							76191	konfirmuar
222	Sahit	Hysen	Kurtaj	2827	6/1	2000	155	233	36115							36115	konfirmuar

223	Sahit	Hysen	Kurtaj	2827	6/8	1000	67	233	15611							15611	konfirmuar
224	Rasim	Binak	Kurtaj	2827	6/7	1000	64	233	14912							14912	konfirmuar
225	Rasim	Binak	Kurtaj	2827	6/3	2000	118	233	27494							27494	konfirmuar
226	Imer	Jakup	Nika	2827	6/4	2000	114	233	26562							26562	konfirmuar
227	Imer	Jakup	Nika	2827	5/6	8300	518	233	120694							120694	konfirmuar
228	Eljona	Kol	Manaj	2827	5/4	5000	311	233	72463							72463	konfirmuar
229	Nikolin	Gjergj	Kola	2827	5/3	2500	101	233	23533							23533	konfirmuar
230	Ardian	Vuksan	Demaj	2827	5/2	5000	217	233	50561							50561	konfirmuar
231	Lodovik		Pecaj	2827	5/1	3200	128	233	29824							29824	konfirmuar
232	Fran	Kole	Kodra	2827	1/5	6000	350	233	81550							81550	konfirmuar
233	Gjergj	Kole	Kodra	2827	1/4	6000	290	233	67570							67570	konfirmuar
234	Zenel	Uc	Burgaj	2827	1/15	5000	330	233	76890							76890	konfirmuar
235	Bllago	Savo	Matanaj	2827	1/6	27500	561	233	130713							130713	konfirmuar
236	Stanko	Ilo	Pjetri	2827	106/12	3700	620	233	144460							144460	konfirmuar
237	Sait	Musa	Neziraj	2299	428/6	2700	1710	217	371070							371070	konfirmuar
238	Rifat	Bajram	Kazmaj	2299	428/5	1000	503	217	109151							109151	konfirmuar
239	Xhelal		Mucaj	2299	258/1	1080	393	217	85281							85281	konfirmuar
240	Arben		Selimi	2299	247	29202	598	217	129766							129766	konfirmuar
241	Petrit	Maliq	Zekaj	2299	217/9	5100	262	217	56854							56854	konfirmuar
242	Ilir		Rexhvelaj	2299	435/4	6875	600	217	130200							130200	konfirmuar
243	Vesel	Preke	Gjetja	1465	803/5	5769	464	207	96048							96048	konfirmuar
244	Tom	Gjek	Gjetja	1465	803/2	1649	327	207	67689							67689	konfirmuar
245	Gjovalin	Ndue	Marku	1465	803/1	6440	2750	207	569250							569250	konfirmuar
246	Jonuz		Kuka	1465	772/4	1674	829	207	171603							171603	konfirmuar
247	Bajram		Kuka	1465	772/2	2312	1040	207	215280							215280	konfirmuar
248	Fatmir	Xhemal	Hasmuja	1465	576/7	4403	27	207	5589							5589	konfirmuar
249	Shaban		Ramçi	1465	574/11	940	350	207	72450							72450	konfirmuar
250	Rifat	Jonuz	Hasmuja	1465	576/6	4463	190	207	39330							39330	konfirmuar
251	Qamil		Ramçi	1465	574/9	1364	119	207	24633							24633	konfirmuar
252	Ramadan	Sokol	Hasmuja	1465	572/1	2310	380	207	78660							78660	konfirmuar
253	Genc	Shyqyri	Smajli	1465	576/10	1800	161	207	33327							33327	konfirmuar
254	Shyqyri	Elez	Smajli	1465	576/9	2486	164	207	33948							33948	konfirmuar
255	Bajram		Ramçi	1465	571/5	1500	128	207	26496							26496	konfirmuar
256	Jashar		Ramçi	1465	571/4	1980			0	193	1355	261515				261515	konfirmuar
257	Idriz	Sokol	Hasmuja	1465	553/2	3100	37	207	7659			0				7659	konfirmuar
258	Rustem		Ramçi	1465	571/1	5806	39	207	8073			0				8073	konfirmuar
259	Hajdar		Gjeta	1465	553/4	3404	148	207	30636			0				30636	konfirmuar
260	Tom	Zef	Narkaj	1465	562/2	2560	87	207	18009			0				18009	konfirmuar
261	Rasim		Ramçi	1465	319/1	1302	265	207	54855	100	1355	135500				190355	konfirmuar
262	Ramadan	Sokol	Hasmuja	1465	555/1	1500	141	207	29187							29187	konfirmuar
263	Fadil		Pavacaj	1465	319/3	2004	322	207	66654							66654	konfirmuar
264	Smajl	Xhelal	Rrukaj	1238	1099	3399	294	256	75264							75264	konfirmuar
265	Sulejman	Dul	Lekaj	1238	1098	4177	230	256	58880							58880	konfirmuar
266	Besnik	Deli	Kurtaj	1238	506	1180	150	256	38400							38400	konfirmuar
267	Besnik	Deli	Kurtaj	1239	500	4642	930	256	238080							238080	konfirmuar
268	Arif		Kukaj	1238	25	35001	3515	256	899840							899840	konfirmuar
269	Skender		Delishaj	1238	28/1	4075	1620	256	414720							414720	konfirmuar
270	Skender		Zekaj	1238	31	16399	2080	256	532480							532480	konfirmuar
271	Smajl		Zekaj	1238	35	13462	1080	256	276480							276480	konfirmuar
272	Isa	Hajdar	Semanaj	2220	57/1	11750	1815	204	370260							370260	konfirmuar
273	Islam	Zenel	Semanaj	2220	58/2	2700	258	204	52632							52632	konfirmuar
274	Faik	Zenel	Semanaj	2220	58/4	2748	789	204	160956							160956	konfirmuar
275	Sabri	Zenel	Semanaj	2220	58/3	2928	816	204	166464							166464	konfirmuar
276	Margarita	Prek	Marçinaj	2220	206/2	13213	279	204	56916							56916	konfirmuar
277	Sabri	Isa	Kurtulaj	2220	203/1	30712	1573	204	320892							320892	konfirmuar
278	Salo		Semanaj	2220	64	2860	73	204	14892							14892	konfirmuar
279	Bade, Zenel, Elez, Hane		Kjaraj	3045	4	655			0	91	911	82901				82901	konfirmuar
280	Bade, Zenel, Elez, Hane		Kjaraj	3045	75/3	2970			0	817	911	744287				744287	konfirmuar

281	Nikoll	Gjergj	Coli	3045	5	975	168	208	34944			0				34944	konfirmuar
282	Luke	Pjeter	Narkaj	3045	75/2	540			0	246	911	224106				224106	konfirmuar
283	Nik	Mirash	Qosja	3045	13	541	167	208	34736			0				34736	konfirmuar
284	Bade, Zenel, Elez, Hane		Kjaraj	3045	75/1	950			0	309	911	281499				281499	konfirmuar
285	Llesh	Preç	Pequshi	3045	74	1000	301	208	62608							62608	konfirmuar
286	Pjeter	Mark	Bushi	3045	48	511	104	208	21632							21632	konfirmuar
287	Viktor	Gjon	Gjonaj	3045	60	487	115	208	23920							23920	konfirmuar
288	Lek	Nikoll	Ulaj	1010	909	13910	158	232	36656							36656	konfirmuar
289	Gjok	Zef	Lumaj	1010	116	6177	269	232	62408							62408	konfirmuar
290	Gjok	Ndok	Curraj	1010	110	5000	417	232	96744							96744	konfirmuar
291	Fadil	Sabri	Celaj	1010	100/1	19200	710	232	164720							164720	konfirmuar
292	Dem Fadil	Sabri	Celaj	1010	937/3	3650	73	232	16936							16936	konfirmuar
293	Dem	Sabri	Celaj	1010	100/6	32462	643	232	149176							149176	konfirmuar
294	Besnik	Elez	Pecaj	1010	574	5284	802	232	186064							186064	konfirmuar
295	Rifat	Sel	Selgjekaj	1010	717/4	692			0	151	1332	201132				201132	konfirmuar
296	Marash	Pal	Vukelaj	1010	704	12166	25	232	5800							5800	konfirmuar
297	Aleksander	Prek	Uldedaj	1989	222	6620	256	224	57344							57344	konfirmuar
298	Arben		Lumaj	1989	221	5005	1023	224	229152							229152	konfirmuar
299	Mark	Fran	Lumaj	1989	220	2058	479	224	107296							107296	konfirmuar
300	Fran	Marash	Lumaj	1989	219	2523	500	224	112000							112000	konfirmuar
301	Kanto	Ded	Lumaj	1989	216/2	1720	497	224	111328							111328	konfirmuar
302	Gjelosh	Vasel	Lumaj	1989	208	2303	127	224	28448							28448	konfirmuar
303	Palok	Gjok	Lumaj	1989	184	8010	2510	224	562240							562240	konfirmuar
304	Tom	Zef	Preknicaj	1989	46	11700	1972	224	441728							441728	konfirmuar
305	Prek	Pashko	Keçaj	1989	113	2000	536	224	120064							120064	konfirmuar
306	Nikoll	Fran	Decaj	1989	58/3	5501	673	224	150752							150752	konfirmuar
307	Gjon	Luc	Gjerkaj	1989	56/6	1081	57	224	12768							12768	konfirmuar
308	Gjon	Luc	Gjerkaj	1989	53/2	5418	1288	224	288512							288512	konfirmuar
309	Eduard	Luigj	Kokaj	3841	673/1	6889	432	217	93744							93744	konfirmuar
310	Marash	Ujk	Popaj	3841	673/9	3000	156	217	33852							33852	konfirmuar
311	Arben	Rrok	Popaj	3841	724/3	3265	639	217	138663	10						138663	konfirmuar
312	Ferdind Tonin		Kalaj	3841	418/9	1936	167	217	36239							36239	konfirmuar
313	Gjon Marash		Popaj	3841	534/14	4623	108	217	23436							23436	konfirmuar
314	Pol	Rrok	Kalaj	3841	441/2	4873	403	217	87451							87451	konfirmuar
315	Ndok	Prek	Kalaj	3841	442/6	3636	264	217	57288							57288	konfirmuar
316	Vasel	Mark	Kalaj	3841	418/8	1686	32	217	6944							6944	konfirmuar
317	Pashko	Pjeter	Kokaj	1964	986	42640	1870	228	426360	300	772	231600				657960	konfirmim
318	Zef	Mark	Camaj	1964	929	5995	346	228	78888							78888	konfirmim
319	Llesh	Nikoll	Shabaj	1964	933	1897	311	228	70908							70908	konfirmim
320	Nikoll	Gjok	Celaj	1964	980	3000	841	228	191748							191748	konfirmim
321	Luigj	Gjergj	Camaj	1964	927	3596	117	228	26676							26676	konfirmim
322	Smajl Fatmir	Ali	Rexhaj	1766	1067/19	4300	680	237	161160							161160	konfirmim
323	Arben		Cokaj	1766	1063/12	8300	322	237	76314							76314	konfirmim
324	Deli	Musa	Beqaj	1766	1063/22	2050	94	237	22278							22278	konfirmim
325	Perparim	Murat	Beqaj	1766	1063/20	3000	39	237	9243							9243	konfirmim
326	Rifat		Beqaj	1766	1063/18	3000	144	237	34128							34128	konfirmim
327	Muhamet	Sali	Beqaj	1766	1063/16	1450	208	237	49296							49296	konfirmim
328	Saimir	Qazim	Canaj	1766	1063/9	4000	144	237	34128							34128	konfirmim
329	Perparim	Ali	Bajramaj	1766	1063/14	6600	315	237	74655							74655	konfirmim
330	Arif		Sejdini	1766	1061/10	11000	1148	237	272076							272076	konfirmim
331	Gjergj	Tom	Demaj	1864	34/4(314)	6000				883	1332	1E+06				1176156	proces giygj.
332	Bardhyl		Hoti	1864	207/27	3156	1409	245	345205	110	1332	146520				491725	konfirmim
	SHUMA						85330		23116119	3991		2E+07	3253		647347	40452866	
	TOTALI															40452866	

VENDIM
Nr.1198, datë 3.12.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.228, DATË 13.4.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DIETAT E NËPUNËSVE, QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË VENDBANIMIT TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 9 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.228, datë 13.4..2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Kur punonjësit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve, që financohen nga Buxheti i Shtetit, shkojnë me shërbim jashtë qendrës së tyre të punës dhe nuk kthehen brenda ditës në vendbanimet e tyre, përfitojnë:

- Dietë, në masën 10 për qind, të pagës mujore, por jo më shumë se 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë;

- Shpenzime fjetjeje, sipas dokumenteve të paraqitura, që e vërtetojnë atë, por jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë për çdo natë;

- Shpenzime udhëtimi, sipas vleftës së biletës së udhëtimit me transport hekurudhor, automobilistik dhe ujor. Kur udhëtimi bëhet me taksi apo furgona, shpenzimet e udhëtimit paguhen sipas çmimeve të miratuara për linjën përkatëse me tren, autobus ose anije, plus 25 për qind të çmimit të biletës së transportit të linjës me autobus, dhe kur nuk ka linjë autobusi, të trenit apo të anijes.".

2. Në pikën 4, shuma "…1400 (një mijë e katërqind) lekë" bëhet "…2000 (dy mijë) lekë…".

3. Në pikën 5, shuma "…600 (gjashtëqind) lekë…" bëhet "…1000 (një mijë) lekë…".

4. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6. Kur shërbimi kryhet, në zona me largësi deri në 100 km, nga qendra e punës, dhe brenda orarit zyrtar të punës nuk paguhet dietë.".

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxhetet e institucioneve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1206, datë 11.12.2009

PËR NJË SHTESË E NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR, NR. 9136, DATË 11.9.2003 "PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE, SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.7983, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa e ndryshimi, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 6 të kreut IV, "Procedurat për regjistrim", shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

"6/1. Njihen periudha sigurimi për efekt të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë":

a) periudhat, nga data 1.10.1993 deri në datë 1.5.2004, për të cilat, të vetëpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pavarësisht nga vendbanimi në kohën e kryerjes së pagesës.

b) periudhat nga data 1.9.1995 deri në datë 1.5.2004, për të cilat, të vetëpunësuarit në bujqësi kanë paguar kontribute deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pavarësisht nga vendbanimi në kohën e kryerjes së pagesës, për rastet, kur toka është blerë, sipas ligjit nr.7983, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave", si dhe për rastet, kur toka është marrë me qira, me akt noterial.

Për njohjen e periudhave të sigurimit shoqëror, sipas shkronjave "a" dhe "b" të kësaj pike, të vetëpunësuarit në bujqësi duhet të paraqesin këto dokumente:

i) Vërtetimin nga komuna/ bashkia se i interesuari ka tokë në pronësi ose në përdorim, duke cilësuar dhe datën, kur është përfituar kjo tokë.

ii) Certifikatën e gjendjes civile (në rastet e largimit, të shënohet dhe data e çregjistrimit nga regjistri i gjendjes civile).

iii) Vërtetimin nga komuna/bashkia se për këtë periudhë ka ushtruar veprimtari, bujqësore e blegtorale.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore nxjerr aktet për trajtimin e të gjitha kërkesave të refuzuara për pension, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.".

2. Pika 8 e kreut IV, "Procedurat për regjistrim", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Kryefamiljarët, që punësojnë persona, si punëtorë shtëpie, i rregullojnë marrëdhëniet e punës, nëpërmjet një kontrate me shkrim, ndërmjet palëve, ku përveç të tjerave shënohen, detyrimisht, numri i sigurimit shoqëror të personit të punësuar, koha e fillimit të punës, zgjatja e saj "me ose pa afat", si dhe paga mujore bruto. Në këtë rast, kryefamiljari përcaktohet në rolin e punëdhënësit dhe dhe si i tillë ka detyrimin për regjistrim në organet tatimore dhe për pajisjen nga këto organe me numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-i). Regjistrimi dhe çregjistrimi

nga organet tatimore bëhen sipas një procedure të thjeshtuar, që përcaktohet me udhëzim nga Ministri i Financave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1214, datë 15.12.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË NJË AUTOMJETI DHE DY TRUPAVE DY TRUPAVE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 17 dhjetor 2009, të një automjeti dhe të 2 (dy) trupave ushatrake italiane.

2. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për automjetin dhe trupat ushtarake italiane është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

3. Automjeti dhe trupat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1216, datë 16.12.2009

PËR DHËNIE ASISTENCE EKONOMIKE TË MENJËHERSHME PERSONAVE, QË PËRFITOJNË PENSION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç” të nenit 66 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një asistence ekonomike të menjëhershme, në shumën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë;

a) personave, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b) personave, që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

c) veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që trajtohen me shpërblim mujor, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 "Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar", personave, që marrin pension për merita të veçanta, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe personave, që marrin pension të posaçëm shtetëror, kur nuk përfitojnë, sipas përcaktimit të shkronjave "a" e "b" të pikës 1 të këtij vendimi.

ç) personave, që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, si dhe personave, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar.

d) personave, që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr.10142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror, suplementar, të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përllogariten, në shumën 1 400 000 000 (një miliard e katërqind milionë) lekë, dhe të përballohen, si më poshtë vijon:

a) 900 000 000 (nëntëqind milionë) lekë, nga Buxheti i Shtetit për vitin 2009, sipas burimeve të mëposhtme:

i) 115 000 000 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë) lekë nga fondi rezervë;

ii) 300 000 000 (treqind milionë) lekë nga fondet e planifikuara për pagesat e interesave të huaja;

iii) 485 000 000 (katërqind e tetëdhjetë e pesë milionë) lekë nga fondet e planifikuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, përkatësisht: 285 000 000 (dyqind e tetëdhjetë e pesë milionë) lekë nga fondet e planifikuara për programin "Mbështetje sociale për ushtarakët" dhe 200 000 000 (dyqind milionë) lekë nga fondet e planifikuara për programin "Forcat e luftimit".

b) 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë nga fondet e programuara në buxhetin e ISSH-së, për vitin 2009.

3. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, në programin "Mbrojtja sociale" t'i shtohet fondi prej 900 000 000 (nëntëqind milionë) lekësh.

4. Fondi prej 1 400 000 000 (një miliard e katërqind milionë) lekësh të përdoret përkatësisht:

a) 1 387 200 000 (një miliard e treqind e tetëdhjetë e shtatë milionë e dyqind mijë) lekë për asistencën e menjëhershme të pensionistëve;

b) 12 800 000 (dymbëdhjetë milionë e tetëqind mijë) lekë për mbulimin e komisioneve të shërbimit të pagesave dhe për shpenzimet e administrimit të tyre.

5. Procedurat e pagesës dhe të administrimit të asistencës së menjëhershme për pensionistët të realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a.

6. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1222, datë 11.12.2009

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të shkronjës "a" të pikës 1, shtohen emërtesat "… Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian dhe Qendra Kombëtare për Aplikimet Energjetike.".

b) Lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Europian, dhe Qendrës Kombëtare për Aplikimet Energjetike, përcaktohen sipas vendimit për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare, për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për këto institucione për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE TË GRUPIT TË PARË

PAGA MUJORE					
Pozicioni	**Kategoria**	**Paga individuale (paga bazë)**			**Shtesa e pozicionit**
		1	**2**	**3**	**4**
		Paga e Grupit (PG)	**Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)**	**Shtesa për kualifikim (SHK)**	**Shtesa e pozicionit (SHP)**
Titullar i institucionit	II-a	12 000	2%		105 000
Z/titullar i institucionit. Inspektor në Agjensinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Europian	II-b	12 000	2%		88 000
Drejtor Drejtorie. Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve. Menaxher trajnimi	III-a	12 000	2%		69 000
Përgjegjës sektori	III-a/1	12 000	2%		60 000
Përgjegjës sektori. Inspektor	III-b	12 000	2%		52.000
Specialist	IV-a	12 000	2%		41.000
	IV-b	12 000	2%		31 000

VENDIM
Nr.1223, datë 11.12.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 13 dhjetor 2009, të një autokolone ushtarake sllovene, të përbërë nga 1 (një) automjet dhe 5 (pesë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit – Qafë-Thanë, në datën 14 dhjetor 2009, të një autokolone ushtarake sllovene, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 5 (pesë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 13 dhjetor 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 14 dhjetor 2009, është Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Autokolonat ushtarake sllovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1224, datë 11.12.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË TRI AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 13 dhjetor 2009, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, të dy autokolonave ushtarake italiane të përbëra:

- Autokolona e parë nga 15 (pesëmbëdhjetë) automjete dhe 35 (tridhjetë e pesë) trupa.
- Autokolona e dytë nga 10 (dhjetë) automjete dhe 22 (njëzet e dy) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 16 dhjetor 2009, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 10 (dhjetë) automjete dhe 25 (njëzet e pesë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat, që do të kalojnë në datën 13 dhjetor 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që do të kalojë në datën 16 dhjetor 2009, është Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1227, datë 11.12.2009

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet emërtesa "… Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit.".

2. Pagat e punonjësve të tjerë mbështetës të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit të përcaktohen sipas vendimit për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

3. Efektet financiare, për vitin 2009, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për këtë institucion, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e emërimit të nëpunësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 21.12.2009
Doli nga shtypi më 21.12.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë